



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:131431

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05657486

**C.nr.266/22**

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil**, gjyqtari Petrit Curri me bashkëpunëtorin profesional Visar Morina, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Xh.H.nga fshati C./Malishevë, të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve "SCLR Partners" Sh.P.K. me seli në Prishtinë, soliteri Avalla P+12, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinë, rruga "Luan Haradinaj" nr.99, me objekt kontesti: "Kompensimi i shujtave dhe pagës shtesë (pagës së trembëdhjetë)", vlera e kontestit **2,320.96 euro**, jashtë seancës gjyqësore me datë 07.05.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**-Për shkak të pa-dëgjueshmërisë/mosbindjes**

- I. **APROVOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit Xh.H.nga fshati C./Malishevë, dhe **DETYROHET** e paditura Ministria e Punëve të Brendshme-Policea e Kosovës-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinë, që paditësit Xh.H. në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 t'ia paguaj për çdo vit shumën nga 580.24 €, ose në total shumën prej **2,320.96 €** ( $580.24 \times 4 = 2,320.96$  euro) me kamatë ligjore në lartësi prej 8 % në vit, e cila fillon të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë (28.04.2022) e deri në pagesën definitive.
- II. **REFUZOHET** si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumën e aprovuar e deri në shumën e kërkuar, ose shumën prej 4,270.24 euro, dhe atë në emër të pagës së trembëdhjetë për fund vitin 2022 shumën prej 580.24 euro dhe në emër të kompensimit për ushqim (shujta) shumën prej 3,690.00 euro.
- III. **OBLIGOHET** e paditura që paditësit pjesërisht t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 104.00 euro në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit, ndërsa refuzohet pjesa tjetër mbi shumën e aprovuar, dhe gjithashtu **refuzohet** kërkesa e paditësit me të cilën ka kërkuar që i padituri t'ia paguaj shpenzimet për taksën gjyqësore në shumën prej 61.00 euro.
- IV. Paditësi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore.

**A r s y e t i m**

Pretendimet e palëve

Paditësi Xh.H. nga fshati C./Malishevë, të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve "SCLR Partners" Sh.P.K. me seli në Prishtinë, në këtë gjykatë me datë 28.04.2022 ka paraqitur padi kundër të paditurës Policia e Kosovës-Ministria e Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar kompensimin e shujtave dhe pagës shtesë (pagës së trembëdhjetë), me arsyetimin se paditësi ka kontratë pune me kohë të pacaktuar me të paditurën në pozitën e zyrtarit policor nga data 14.06.2004, ka pagë mujore në lartësi prej 580.24 euro dhe gjatë kësaj kohe ka performancë të shkëlqyer, kështu që bazuar me dispozitën e nenit 29 par. 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i takon kjo e drejtë.

Paditësi ka theksuar se ka parashtruar kërkesë të punëdhënësi për kompensimin e shujtave ditore dhe pagesën e një page mujore në fund të çdo viti kalendarik, mirëpo e paditura nuk është përgjigjur, dhe duke u ndodhur në këtë situatë, paditësi është detyruar të parashtrroj padi për kompensimin e kërkesave të tij.

Nga arsyet e paraqitura në padi, paditësi ka kërkuar nga gjykata që të obligoj të paditurën që në emër të kompensimit të pagës së trembëdhjetë për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 t'ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 2,320.96 euro dhe në emër të kompensimit të shujtave ditore nga 5 euro për një ditë pune, respektivisht për 738 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej 3,690.00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % nga dita kur kërkesat kanë arritur për përmbushje e deri në pagesën përfundimtare.

I autorizuari i paditësit, me datën 20.02.2024, ka dorëzuar parashtrësë për precizimin e padisë ku përveç dorëzimit të disa provave, ka bërë edhe precizimin e kërkesëpadisë ashtu që ka kërkuar ti kompensohet paga e trembëdhjetë edhe për vitin 2022 në shumën prej 580.24 euro ose tani për pesë (5) paga të trembëdhjeta (2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022) në shumën e përgjithshme prej 2,901.20 euro, kurse pjesa tjetër e petitimit mbetet e pandryshuar edhe pse ka thënë se në bazë të listës së pagave, paditësi ka realizuar pagë më të lartë, mirëpo i njëjti si shpërblim kërkon vetëm lartësinë e pagës bazë sipas vërtetimit të punësimit.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 156.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore, shumën prej 61.00 euro.

Me aktvendimin C.nr.266/22 të datës 16.02.2024, gjykata e ka detyruar të paditurën që të përgjigjet në padi, nën paralajmërimin se nëse nuk paraqet përgjigje në padi në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit të lartpërmendur, gjykata do të merr aktgjykim në bazë të pa dëgjueshmërisë/mosbindjes.

E paditura, edhe pse aktvendimin C.nr.266/22 të datës 16.02.2024 të kësaj Gjykate e ka pranuar me datë 27.02.2024, me çka konstatohet nga fletë kthesa e dorëzuar me anë të shërbimit postar të kësaj Gjykate, e njëjta nuk është përgjigjur në padi edhe sot e kësaj dite dhe gjithashtu nuk ka kthyer përgjigje as ndaj parashtrësës për precizimin e padisë, të cilën parashtrësë e ka pranuar me datë 26.02.2024.

Gjykata pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të pa dëgjueshmërisë nga neni 150 paragrafi 1 pika a), b) dhe c) të LPK-së, për arsye se të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, dhe nga ana tjetër themelësia e kërkesëpadisë ka dalë nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi.

### Provat dhe vlerësimi i tyre

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka vlerësuar dhe administruar këto prova: Kërkesën e paditësit për kompensim të shujtave dhe pagës shtesë, drejtuar të paditurës nr.... të datës 21.03.2022, vërtetimin e punësimit nr. ref. ... të datës 23.02.2022, kontrata e punës nr.... e datës 31.05.2010, listat e pagave nga buxheti i Republikës së Kosovës, lista për ditët e angazhuara në punë për periudhën 2018-2022, formularët e vlerësimit të performancës për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, librezat e anëtarësisë së lidhjes së invalidëve dhe viktimave civile të luftës së Kosovës nr.... dhe vendimi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i datës 24.04.2014.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, gjykata ka konstatuar se në mes palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e ka vërtetuar edhe nga vërtetimi i punësimit nr. ref. ... të datës 23.02.2022, nga i cili vërtetohet se paditësi është në marrëdhënie pune nga data 14.06.2004 dhe se realizon pagë mujore në shumën prej 580.24 euro.

Se paditësi është marrëdhënie pune tek e paditura, këtë e vërteton edhe kontrata e punës nr.... e datës 31.05.2010 e lidhur mes palëve ndërgjyqëse.

Nga kërkesa me nr.... e datës 21.03.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka bërë kërkesë tek e paditura për pagesë të shujtave dhe pagës shtesë, por nuk ka marrë përgjigje.

Sic u cek më lart, nga vërtetimi i punësimit, gjykata ka konstatuar se paditësi e ka filluar punën tek e paditura nga data 14.06.2004 dhe realizon pagë mujore në shumën prej 580.24 €, ndërsa bazuar në listat e pagave paditësi realizon pagë neto më të madhe duke futur këtu edhe ndërrimet e natës, rrezikshmërinë dhe kompensimet tjera.

Nga formularët e vlerësimit të performancës për vitet kalendarike 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka pasur vlerësim me notën 4 që korrespondon me vlerësimin plotësisht të kënaqshëm.

Bazuar në listat për ditët e angazhuara në punë për periudhën nëntor 2018 deri shkurt 2022, vërtetohet se paditësi ka qenë i angazhuar në punë gjithsej 738 ditë.

Bazuar në librezën e anëtarësisë së lidhjes së invalidëve dhe viktimave civile të luftës së Kosovës nr.174/12 dhe bazuar në vendimin nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i datës

24.04.2014, vërtetohet fakti se paditësi është anëtar i Familjeve të Viktimave Civile të Luftës, për çka edhe është liruar nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore.

Baza ligjore dhe vlerësimi i gjykatës

Vërtetimin, kontratën e punës si dhe formularët e lartcekur, gjykata i ka pranuar si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, andaj vërtetimit dhe kontratës me të cilin është konstatuar se paditësi është në marrëdhënie pune pranë të paditurës dhe formularëve me të cilin është bërë vlerësimi i punës së paditësit, gjykata ua fali besimin e plotë.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 150 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit pjesërisht duhet aprovuar.

Siç u tha më lart, gjykata pas analizimit të shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, ka gjetur se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të pa dëgjueshmërisë nga neni 150 paragrafi 1 pika a), b) dhe c) të LPK-së ku përcaktohet se:

*“Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte”:*

a) *“Po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi”*,

b) *“Po që se themelësia e kërkesëpadiës del nga faktet e treguara në padi”* dhe

c) *“Po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht”*

Bazuar në faktet e çështjes, gjykata gjen se lidhur me kërkesën e aprovuar të paditësit për kompensimin e pagës së 13-të për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, i cili ka qenë në fuqi prej datës 14.11.2018 deri 29.09.2021 dhe bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.213/2023 të datës 09.10.2023 për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës.

Në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 përcaktohet se: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*, ndërsa me nenin 44 par. 2 të Ligjit Nr. 04/L-076 për

Policinë përcaktohet se: *“Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”, kurse neni 55 par.1 nën par.1.7 i këtij Ligji përcakton se: “Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”.*

Me nenin 29 paragrafi 2 të UA nr.02/2018 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”, kurse neni 30 paragrafi 2 të UA nr.01/2021 përcakton se: “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore”, ndërkaq bazuar edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.213/2023 të datës 09.10.2023, për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës, në pikën -II- është paraparë se: *“Në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë të nenit 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021”.**

Nga interpretimi i dispozitave të lartcekura, të Udhëzimit Administrativ 02/2018 i cili është nxjerrë nga e paditura, Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit sa i përket shpërblimit për pagën e 13-të për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 është e bazuar, sepse paditësi e gëzon të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik ta përfitoj si shpërblim një pagë mujore, e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik punonjësi i të paditurës, në këtë rast paditësi, të ketë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës dhe të mos i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës.

Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit të performancës që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se paditësi ka vlerësim të kënaqshëm të performancës dhe të njëjtit nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore gjatë viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Për më tepër nga e paditura nuk është shqiptuar ndonjë masë disiplinore eventuale ndaj paditësit.

Me rastin e vendosjes lidhur me detyrimin si në pikën -I- të dispozitivit dhe lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fund viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021, gjykata mori për bazë vërtetimin e punësimit, të vlerësuar si më lart, nga i cili rezulton paga e paditësit, andaj të njëjtit për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 i takon shuma ashtu siç edhe është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi (paga 580.24 euro x 4 vite = 2,320.96 euro).

Gjykata, vlerëson se e paditura ka pasur për detyrim sipas dispozitave të lart cituara për ta kompensuar paditësin për pagat e 13-ta, për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, andaj paditësi e ka cilësinë e kreditorit, ndërsa e paditura cilësinë e debitorit dhe kjo bazuar edhe me nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) në të cilin përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*. Së këndejmi gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitave të lartcekura dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shumën e gjykuar.

Për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020, duke filluar me llogaritjen e kamatës nga data 28.04.2022 si ditë e paraqitjes së kërkesëpadisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit.

### Pjesa refuzuese

Lidhur me refuzimin e pjesërishtëm si në pikën -II- të dispozitivit për shpërblimin e pagës, më konkretisht pagës së 13-të për fund vitin 2022 ose shumën prej 580.24 euro, gjykata është bazuar në Udhëzimin Administrativ (UA) nr.01/2021 i datës 29.09.2021 ku me nenin 30 par. 2 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore”* dhe gjithashtu është bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.213/2023 të datës 09.10.2023, për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës, ku në pikën 2 është paraparë se *“Në kontestet nga marrëdhëniet e punës-lidhur me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë të nenit 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021”*.

Pra, bazuar në nenin 30 par. 2 të UA 01/2021 i cili ka hyrë në fuqi me datë 29.09.2021 dhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme, rezulton se realizimi i shpërblimi është i kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, përkatësisht nëse ka mjete buxhetore, derisa neni 29 par. 2 të UA 02/2018 i datës 14.11.2018 dhe i cili ka qenë në fuqi deri me datën 29.09.2021, ka qenë i karakterit detyrues dhe punëdhënësi është i obliguar që edhe për vitin 2021 ti planifikoj mjetet buxhetore.

Gjykata e ka refuzuar në tërësi kërkesën e paditësit për kompensimin e shujtave ditore për gjithsej 738 ditë pune për periudhën kohore nga muaji nëntor 2018 e deri në muajin shkurt

2022, apo shumën prej 3,690.00 €, sepse me paragrafin 1 të nenit 29 të UA nr.02/2018 si dhe të nenit 30 paragrafi 1 të UA nr.01 /2021, përcaktohet se: *“Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”*, dhe pasi që kjo dispozitë ligjore nuk e detyron shprehimisht të paditurën për kompensimin e shujtës ditore ashtu siç ka kërkuar paditësi, gjykata vendosi si në pikën -II- të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe po ashtu duke u bazuar edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës është paraparë se: *”Në kontestet nga marrëdhëniet e punës-lidhur me kërkesat për shpërblimin e shujtës ditore për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, nuk aplikohet neni 29 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe neni 30 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021”*.

Pra, duke u bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme, rezulton se përfshirja e shpërblimit të shujtës ditore është e karakterit deklarativ dhe nuk përcakton detyrime konkrete për punëdhënësin, por vetëm theksojnë se duhet të jenë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, gjithashtu nuk janë përcaktuar as kushtet, mënyra, lartësia dhe realizimi i shpërblimit të shujtës ditore.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore si në pikën -III- të dispozitivit, gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 449 dhe nenit 453 par.1 dhe 2 të LPK-së ku parashihet se: *“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”*, si dhe në bazë të rregullores për tarifat e avokatëve, ashtu që vendosi që paditësit t’ia njoh shpenzimet e procedurës duke e detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj shumën prej 104.00 euro në emër të parashtimit të padisë (sipas numrit tarifor 6 të rregullores për tarifat e avokatëve në kontestet me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri në 10.000 €).

Paditësi u lirua nga pagesa e taksës gjyqësore sikurse në pikën -IV-, bazuar në nenin 468 të LPK-së dhe bazuar në nenin 8 par.1, nën par. 8.1.5 dhe par.3, nën par. 8.3.5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/17 për Unifikimin e taksave gjyqësore, pasi që paditësi është anëtar i Familjeve të Viktimave Civile të Luftës.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe 150 të LPK-së.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.266/22, datë 07.05.2024**

**G j y q t a r i**  
**Petrit Curri**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.